



Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit

NJOFTIM MBI SEANCËN E SHPALLJES SË VENDIMIT PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Z. GJERGJI TAKO

□ □

15/09/2023

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pasi:

- shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e dërguar nga institucionet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gjergji Tako;
- zhvilloi një procedurë të thellë hetimi administrativ;
- dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancat dëgjimore, përkatësisht në datat 27.4.2022 dhe 15.6.2022, në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor;
- njoftoi subjektin dhe shpalli vendimin e ndërmjetëm nr. 9, në datë 17.6.2022, për pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako, për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
- administroi rezultatet e arritura nga subjekti gjatë programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës dhe, pasi i diskutoi ato në dhomë këshillimi, e konsideron të përfunduar seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, procesin për rivlerësimin e subjektit Gjergji Tako.

Trupi gjykues, i përbërë nga z. Roland Ilia kryesues, znj. Etleda Çiftja relatores dhe znj. Pamela Qirko anëtare,

VENDOSI:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall sot, në datë 15.9.2023.